

VENDIM
Nr. 634, datë 15.11.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 381, DATË 29.6.2023, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT NË
KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME DREJTUESE EDHE PËR KANDIDATË
TË TJERË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL, PËR VITIN 2023”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 381, datë 29.6.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për hapjen e procedurës së pranimi në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, për vitin 2023”, pika 11, e kreut I, të lidhjes 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Koordinator në sektorin (zyrën) e menaxhimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm, në Kryeministri.”.

2. Ngarkohen Kryeministria dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku